



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 310/2025
Datë: 30 prill 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 30 prill 2025, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Z. Atnor Skoro, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prizren, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren nga data 15 maj 2025.
2. Obligohet z. Atnor Skoro që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
3. Z. Atnor Skoro ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore.
4. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 30 prill 2025 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 16 prill 2025, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Atnor Skoro;
- Kryeprokurorit të PTH Prizren;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.

